



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 205, datë 11.06.2020

PËR

PËRSËRITJEN E TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM TË GJYQTARIT {...} NË GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR KAVAJË

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 46 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 të KLGJ-së “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, i ndryshuar, në vendimet e tij nr. 96, datë 21.06.2019 dhe nr.195, datë 04.06.2020, si dhe duke mbajtur në konsideratë dhënien e pëlqimit të gjyqtarit {...} me shkresën nr. 2624 prot., datë 04.06.2020, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

VENDOSI:

1. Gjyqtarit {...}, aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, për një periudhë deri në 1 (një) vit.
2. Efektet e këtij vendimi fillojnë nga data 22.06.2020.
3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarit z. {...}, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR